



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 21.11.2019, ora 10:30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013.

**Marrin pjesë:** Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Klotilda Bushka, Andrea Marto, Bashkim Fino, Ilir Xhakolli, Adnor Shameti

**Mungojnë:** Tritan Shehu, Klajda Gjoshja, Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Nard Ndoka, Edmond Panariti, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Edi Paloka

**Të ftuar:**

Agim Bregasi - Drejtor në Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë

Fatmir Elezi - Inxhinier në KESH

Anisa Pina - Specialiste në Ministrinë e Energjisë

Brikena Jazxhi - specialiste në Ministrinë e Financave

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëmëngjesi!

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31. 12. 2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”.

Më duhet t’ju them se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje me ndryshimet përkatëse ka ardhur si nevojë urgjente (*të më korrigjojnë ekspertët nëse gaboj*) e punimeve që nevojiten të bëhen në hidrocentralin e Komanit përpara se të fillojnë shirat e mëdha dhe situata të përkeqësohet. Jam e saktë?

Zëvendësministrja nuk ka ardhur, sepse është në mbledhjen e qeverisë. Të pranishëm janë drejtori i Drejtorisë Elektroenergjetike, zoti Bregasi, si dhe dy zotërinj të tjerë, një nga Ministria e Financave dhe një nga KESH-i

Zoti Bregasi, fjala është për ju, por ju lutem shumë shkurt.

**Agim Bregasi** – Faleminderit!

Mirëmëngjesi!

Sikurse e përmendi edhe zonja kryetare, ne këtu po kërkojmë ndryshimin e marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2012 për ndërhyrjen në projektin e madh të sigurisë së digave. Në fakt, me BERZH-in ne kemi pasur një marrëveshje për 12,7 milionë euro, por pas përfundimit të punimeve sipas standardeve dhe me cilësi, ka tepruar një sasi parash prej 6, 128 milionë euro të tjera. Këto do të shkojnë përsëri për rritjen e sigurisë së digave, por jo për ato zëra që kanë qenë parashikuar në vitin 2012.

Me këtë marrëveshje ne kërkojmë vetëm të ndryshojmë destinacionin e parave të mbetura. Pra, nga punimet që tashmë janë bërë, të shkojnë për riparimin e portave të remontit dhe punës të hidrocentraleve të Komanit dhe Fierzës. Natyrisht, domosdoshmëria e tyre është e evidente për ne që njohim sektorin, sepse që kur Komani dhe Vau i Dejës janë vënë në punë para 30-40 vjetëve, nuk është ndërhyrë në këto porta. Kjo shumë i shtohet shumë prej 12 milionë euro të dhëna nga Banka Botërore, që ne e kaluam në parlament para dy muajve. Pra, e gjithë kjo shumë do të shkojë për riparimin e portave të remontit dhe të punës së hidrocentraleve të Komanit dhe të Vaut të Dejës dhe për rehabilitimin e agregatit nr. 4 të hidrocentralit të Komanit. E kërkojmë me urgjencë edhe për shkak të kushteve të favorshme për të punuar. Pavarësisht se në kuptimin energjetik nuk janë të favorshme, sepse kuotat kanë rënë shumë, por janë të përshtatshme për të bërë manovrime me portat.

Nga ana tjetër, kur kemi miratuar shumën prej 12 milionë euro para dy muajve, Banka Botërore ka vënë si kusht që duhet miratuar edhe shuma prej 6,128 milionësh me BERZH-in që të bëhet paketa e plotë. Pra, kemi garanci edhe nga Banka Botërore që e gjithë sasia e parave 12 milionë euro dhe 6, 128 milionë euro është e garantuar për të realizuar këto punime.

Në përfundim, ne kërkojmë që të ndryshohet destinacioni i 6, 128 milionë eurove dhe të shtyhet afati, sepse me marrëveshjen e viti 2012 ishte parashikuar që për këto skadonte afati, por me punimet shtesë që po bëjmë, kërkojmë që të shkojë deri në vitin 2021. Këto dy gjëra kërkohen në marrëveshjen që i është bashkëlidhur këtij relacioni dhe vendimi që do të merret.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit juve!

Ka pyetje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Inxhinieri është ekspert. Të mos jetë shterues edhe inxhinieri, atëherë çfarë u pa këtu?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për ne duhet të kishte hyrë në fuqi menjëherë.

Zoti Bregasi, ju nuk keni limite kohore të tipit që deri në fund të vitit duhet të konsumoni këtë pjesë të fondit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ngaqë flasim për urgjencën.

**Agim Bregasi** – Urgjenca është kushti që ka vënë Banka Botërore. 12 milionë euro, që ne miratuam para dy muajve, ajo nuk i vë në dispozicion për të bërë këto punime pa u miratuar edhe kjo, që të jetë paketa e plotë. Kjo është një nga emergjencat që ne kemi dhe që kërkojmë zgjidhje.

E dyta, janë kushtet që janë krijuar në rezervuarët e Fierzës dhe Komanit me nivele të ulëta, që e lehtësojnë punën për të realizuar këto ndërhyrje.

Ajo që nuk është në relacion, por që ne mund ta kishim si kërkesë suplementare dhe ka kaluar edhe te Komisioni i Ekonomisë, është që të miratohet dhe të hyjë në fuqi menjëherë. Besoj se edhe Komisioni i Ekonomisë do ta përfshijë në vendimin e parlamentit.

**Mimi Kodheli** – Besoj se nesër, meqë kjo ka qenë diçka urgjente ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetëm për ndryshim destinacioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e bën dot.

Faleminderit!

Unë mendoj ta hedhim në votim.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Zoti Bregasi, faleminderit për prezencën dhe punë të mbarë!

Faleminderit kolegëve për vajtje-ardhjen!

**MBYLLET MBLEDHJA**